

Te drejtat e mija

Broshurë në gjuhë të lehtë



Grupet kontrolluese:

Falënderojmë të
rinjtë e Qendrës
Ditore “Jetë në
Zhvillim” Bubq

Valeriol Balliu
Ledjan Dobrozi
Armando Skeja
Arjan Murati
Elona Dani
Blerim Marashi

Falënderojmë të
rinjtë e Shkollës
Speciale “3
Dhjetori” Shkodër

Blerim Muharremi
Muhamet Puci
Megi Bekshiu
Sulejman Manjani
Alban Morina
Darjo Kolnikaj



© European Easy-to-Read Logo: Inclusion Europe.
Për më shumë informacion:

www.inclusion-europe.eu/easy-to-read

E drejta për shëndetësi



- Çdo person ka të drejtë të marrë ndihmë nga mjeku.
- Kur je i sëmurë, mund të shkosh në qendrën shëndetësore ose spital. Shërbimet bazë mjekësore janë falas.
- Të gjithë marrin shërbim mjekësor njësoj.
- Fëmijët dhe gratë shtatzëna kanë kujdes të veçantë shëndetësor.
- Të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara kanë kujdes të veçantë shëndetësor.

E drejta për arsim



- Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të shkojnë në shkollë.
- Arsimi fillor është falas dhe i detyrueshëm.
- Vajzat dhe djemtë kanë të njëjtën të drejtë për shkollim.
- Arsimi i mirë ndihmon që të kesh më shumë mundësi pune në të ardhmen.
- Të gjithë duhet të shkojmë në shkollë.

E drejta për të votuar



- Kur mbush 18 vjeç, ti ke të drejtë të votosh.
- Votimi është i fshehtë.
- Askush nuk duhet të dijë se për kë voton.
- Ti ke të drejtë të marrësh pjesë në zgjedhje.

E drejta për drejtësi



- Ligji mbron çdo person në mënyrë të barabartë.
- Nëse dikush të dëmton, ti ke të drejtë të ankoresh në gjykatë.
- Ke të drejtë të mbroresh nga një avokat.
- Të gjithë jemi të barabartë para ligjit.

E drejta për të shprehur mendimin



- Ti ke të drejtë të thuash mendimin tënd.
- Mund të shkruash e të flasësh lirshëm.
- Duhet të kemi respekt për të tjerët.
- Ke të drejtë të marrësh informacion nga gazeta, televizioni ose interneti.
- Nuk duhet të fyejme të tjerët.

E drejta për jetë të sigurt



- Ti ke të drejtë të jetosh në një shtëpi të sigurt.
- Askush nuk duhet të të trajtojë me dhunë.
- Ti ke të drejtë të mbrosh pronën tënde.
- Shteti duhet të të mbrojë nga rreziqet dhe nga padrejtësitë.

Detyrat e tua si qytetar



- Respekto ligjet.
- Paguaj taksat.
- Respekto të tjerët.
- Kujdesu për mjedisin.
- Merr pjesë në jetën shoqërore.
- Ndihmo të tjerët.



Për të përmirësuar punën tonë, ju lutemi vlerësoni tekstin. Këtë mund ta bëni duke skanuar kodin QR ose nëpërmjet linkut:

<https://forms.gle/U6jbFcMp4PdXwiUGA>